



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA FUSHE ARREZ  
Sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

Nr. 401 Prot

Fushë-Arrëz, me 10.02.2025

**SHPALLJE PËR LËVIZJEN PARALELE DHE PËR PRANIMIN NË  
SHERBIMIN CIVIL**

Lloji i diplomës "Shkenca Ekonomike " niveli minimal i diplomës "Master"

Në zbatim të nenit 26, të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, Sektori i Burimeve Njerëzore pranë Bashkisë Fushë-Arrëz shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për pozicionin si më poshtë:

**1( nje) Specialist Kontabiliteti, kategoria IV-3**

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant , ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së konkurimit nga jashtë.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil) aplikohet në të njëjtën kohë !

Afati për dorëzimin e dokumentave për LËVIZJE PARALELE	26.02.2025
Afati për dorëzimin e dokumentave për NË SHËRBIMIN CIVIL	26.02.2025

**Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionet si më sipër është:**

- Regjistrimi dhe përpunimi i transaksioneve financiare sipas parimeve të kontabilitetit.
- Mbajtja dhe azhurnimi i librave të kontabilitetit dhe dokumentacionit financiar.
- Përgatitja e raporteve financiare mujore, tremujore dhe vjetore.
- Kontrolli dhe pajtimi i llogarive bankare dhe të klientëve/furnitorëve.

- Sigurimi i përputhshmërisë me legjislacionin fiskal dhe financiar.
- Përgatitja dhe dorëzimi i deklaratave tatimore dhe raporteve për autoritetet përkatëse.
- Mbështetja e auditimeve të brendshme dhe të jashtme duke ofruar dokumentacionin e nevojshëm.
- Menaxhimi i arkës, faturave dhe pagesave të ndryshme.
- Analiza financiare dhe ofrimi i rekomandimeve për përmirësimin e proceseve financiare.

## 1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:**

- Të jenë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (IV-3)
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi
- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit "mirë" apo "shumë mirë"

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master" ( minimalisht ) në Shkenca Ekonomike , Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit duhet të jenë të njesuara pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave.
- Të kenë të paktën 2 vit përvojë pune.
- Të kenë njohuri të mira të paketës Aftësi të shkëlqyera në përgatitjen dhe analizimin e dokumenteve ligjore.
- Të kete aftësi të mira organizative dhe menaxheriale.

## 1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore të Bashkisë Fushë-Arrëz dokumentat si më poshtë:

- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

### **1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën 27.02.2025, Sektori i Burimeve Njerëzore do të shpallë në Këndin e Njoftimeve të Bashkisë Fushë-Arrëz, faqen zyrtare të internetit dhe në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta duhet të paraqiten në Zyrën e Burimeve Njerëzore pasi do të njoftohen individualisht për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

### **1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Ligji Nr. 9228, datë 29.04.2004, i ndryshuar – "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"
- Ligji Nr. 8438, datë 28.12.1998, i ndryshuar – "Për tatimin mbi të ardhurat"
- Ligji Nr. 92/2014 – "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar – "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji Nr. 9936, datë 26.06.2008, i ndryshuar – "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji Nr. 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar – "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji Nr. 10383, datë 24.02.2011, i ndryshuar – "Për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor"

### **1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:**

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Sektori i Burimeve Njerëzore do të shpallë fituesin në Këndin e Njoftimeve të Bashkisë Fushe-Arrez dhe në portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht nëpërmjet adresës së email-it të vendosur në jetërshkrim.

## **2. PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL**

Vendim në rast se posaçërisht vendim në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezultimi do të jetë ende i paqartë, siç është i vërejtshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil. Këto informacione do të merren në këndin e Njoftimeve të Bashkisë Fushe-Arrez dhe në portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit, duke filluar nga data 27.02.2025.

### **2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA**

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar.

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:**

- a - Të jetë shtetas shqiptar;
- b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f - Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

- a - Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master" ( minimalisht ) në Shkenca Ekonomike , Diplomë të cilat janë marrë jashtë vendit duhet të jenë të njesuara pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave.
  - b- Të kenë të paktën 2 vite përvojë pune.
- c - Të kenë njohuri të të mira të paketës Aftësi të shkëlqyera në përgatitjen dhe analizimin e dokumenteve ligjore.
- d - Të ketë aftësi të mira organizative dhe menaxheriale.

### **2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

**Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:**

- a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://www.dap.gov.al/legislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>

- b - Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhen pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore të Bashkisë Fushe-Arrez Brenda datës **25.02.2024**

### **2.3** REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **27.2.2025** Sektori I Burimeve Njerëzore do të shpallë në Këndin e Njoftimeve dhe në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret e veçanta për procedurën e pranimit nga jashtë, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kriteret e veçanta për procedurën e pranimit nga jashtë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

### **2.4** FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Ligji Nr. 9228, datë 29.04.2004, i ndryshuar – "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"
- Ligji Nr. 8438, datë 28.12.1998, i ndryshuar – "Për tatimin mbi të ardhurat"
- Ligji Nr. 92/2014 – "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar – "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji Nr. 9936, datë 26.06.2008, i ndryshuar – "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji Nr. 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar – "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji Nr. 10383, datë 24.02.2011, i ndryshuar – "Për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor"

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

### **2.5** MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për

karrierën, deri në 40 pikë;

c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike "ëëë.dap.gov.al"  
<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

## 2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Sektori i Burimeve Njerëzore do të shpallë fituesin në Këndin e Njoftimeve të Bashkisë Fushe-Arrez dhe në portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht nëpërmjet adresës së email-it të vendosur në jetëshkrim.

Përgjegjësia e Sektorit të Burimeve Njerëzore

Fatona Selimaj



KRYETARI

Hi CURRI

